



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erblin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL Datë: 22.07.2025 VI-020-296/7
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit Vjosa Ahmetaj, Zytare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve Komunale
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Ferizajt
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e kuvendit të komunës në vijim:

Vendim 01.Nr. 69 për pezullimin e Vendimit 01.Nr. 38 të datës 30.04.2025

I miratuar më datë: 30.06.2025

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.07.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2025, ka miratuar Vendimin 01.Nr. 69 për pezullimin e Vendimit 01.Nr. 38 të datës 30.04.2025.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt, është bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008", dhe në nenin 51 pika 2.9 e Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, me qëllim pezullimin e Vendimit 01.Nr. 38 të datës 30.04.2025, përmes të cilit është miratuar memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Ferizajt dhe Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe fëmijëve "Shtëpia Ime", Ferizaj.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Ferizajt me datë 30.06.2025, dhe është miratuar më 23 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

MAPL, ju njofton se Vendimi në fjalë pas kalimit të afatit për pezullim, nuk mund të filloj të zbatohet pa u harmonizuar sipas kërkesës për rishqyrtim nga MAPL Nr. 020-296/5 të datës 30.05.2025.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Agim Aliu, gradonačelnik opštine Uroševac Xhavit Zariqi, predsedavajući Skupštine opštine Uroševac	
Kopija:	Jedinici za admistriranje dokumenata u MALS-u Jedinici za admistriranje dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a	
Od:	Erblin Hetemi, direktor Pravnog odeljenja u MALS-u	
Odgovorni službenici:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za razmatranje zakonitosti akata i akata gradonačelnika opštine Vjosa Ahmetaj, viša službenica za razmatranje zakonitosti opštinskih akata	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Uroševac	
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa članom 9, Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju akata opština, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi sledeći opštinski akt:

Odluka 01.br. 69 o suspendiranju Odluke 01.br. 38 od dana, 30.04.2025.
Usvojena dana, 30.06.2025.
Podnešena na razmatranje u MALS-u dana, 02.07.2025

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da je akt opštine u proceduralnom smislu u u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Uroševac, na sednici održanoj dana, 30.06.2025. godine, usvojila je **Odluku 01.br. 69 o suspendiranju Odluke 01.br. 38 od dana, 30.04.2025.**

MALS, konstatuje da je odluka koju je izdala Skupština opštine Uroševac zasnovana na članu 12. Zakona 03/L-040 o lokalnoj samoupravi „Službeni glasnik Republike Kosovo br. 28/2008“ i na članu 51. tačka 2.9 Statuta opštine 01. br. 50 od 28.06.2013. godine, u cilju suspendiranja Odluke 01. br. 38 od dana 30.04.2025. godine, kojom je odobren memorandum o razumevanju između opštine Uroševac i Centra za zaštitu žena i dece „Moja kuća“, Uroševac.

Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Uroševac dana, 30.06.2025, sa 23 glasa „da“, 0 „protiv“ i 0 „uzdržanih“.

MALS, vas obaveštava da je navedena odluka nakon isteka roka za suspendiranje, ne može se sprovesti bez usklađivanja prema zahtevu za reviziju od strane MALS-a br. 020-296/5 od dana, 30.05.2025.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.